



Datë: 27.10.2025
Numër Protokolli: 6999/2025

A.nr.1688/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje: Eshref Shabani kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi, dhe Malsore Gashi-Bajraktari anëtar, me Ilire Mehmeti-Shaqir-procesmbajtëse, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1688/2025, të datës 12.09.2025, të parashtruar nga ankuesi V.L, kundër organit të punësimit: Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*kërkese nga marrëdhënia e punës*”, në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 27.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1688/2025, e datës 12.09.2025, e parashtruar nga ankuesi V.L, ashtu që **shfuqizohet** Vendimi nr.2514-1/2025 i datës 15.08.2025 i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve, ndërsa lënda kthehet ***në rishqyrtim*** dhe ***rivendosje*** tek organi i njëjtë.

II. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, V.L (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), i punësuar në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve, më datë 12.09.2025 ka parashtruar ankesën me numër protokolli 6122/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli Nr.226/2025 të datës 15.08.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve, me të cilin vendim i është refuzuar kërkesa për lejimin e orarit të shkurtër të punës të cilën ka qenë duke e shfrytëzuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, ndërsa

kjo e fundit, më datë 06.10.2025 ka përcjellë përgjigjën në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës në çështjen përkatëse ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto **prova**: Ankesën me numër protokolli 6122/2025 të datës 12.09.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokolli 2514-1/2025 të datës 15.08.2025; Kërkesën me numër protokolli 2514/2025 të datës 13.08.2025; Aktin e emërimit me numër protokolli 53 të datës 11.12.2019; Aktin e emërimit me numër protokolli 921/2024; Raportin mjekësor të datës 04.01.2021; Raportin mjekësor të datës 08.09.2025; Emalin e datës 07.08.2025 të K.D drejtuar V.L; Flete zotimin me numër protokolli 05-5635 të datës 15.09.2016; Aplikacionin e datës 14.09.2016 për pjesëmarrje në Programin për trajtim jashtë vendit; Raportet mjekësore të lëshuara nga Qendra Laserike e syrit Kurbati për vitin 2016; Raporti për ndërprerjen e përkohshme të punës me pagesë për periudhën kohore 14.06.2016 deri me 04.07.2016; Kërkesën për pushim të datës 14.06.2016 deri me datën 04.07.2016; Dokumentin e identifikimit të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 29.09.2025; Përgjigjen në ankese me numër protokolli 1688/2025 të datës 06.10.2025; Kërkesën me numër protokolli 3807 të datës 22.10.2019; Listën e pagave për muajin Korrik, Gusht, Shtator, -2025;

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka gjetur se ankesa është e bazuar dhe se lënda duhet të kthehet në **ri-shqyrtim** dhe **rivendosje te organi i njëjtë, sepse**:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi sipas Akt emërimit me numër protokolli 53 të datës 11.12.2019, është i punësuar në pozitën e punës “Zyrtar i Lartë për Hartimin e Politikave Pensionale” në Departamentin e Pensionave në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve. Si rrjedhojë, i njëjti sipas akt emërimit të datës 11.12.2019 ka kryer punë me orar të reduktuar njëzet (20) orë në javë pa afat kohor. Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtar Publik sipas nenit 102 të gjitha Institucionet e Kosovës kanë qenë të obliguara që ti ofrojnë nëpunësve Aktet e reja të emërimit, ku me datë 04.05.2024 ankuesi ka nënshkruar aktin e emërimit me numër protokolli 921/2024 për të njëjtën pozitë në të cilin nuk ka qenë i përcaktuar numri i orëve të punës.

Tutje Njësia për Menaxhimin e Burimeve njerëzore përmes emailit të datë 07.08.2025 ka njoftuar ankuesit se i njëjti duhet të punoj me normën e plotë në punë prej 40 orë në javë, pasi që nuk ka ndonjë kërkesë zyrtare apo vendim për angazhim të reduktuar me 20 orë në javë, duke lënë të nënkuptohet se ankuesi duhet të jetë prezent në vendin e punës duke përmbushur detyrat e punës dhe përgjegjësit që dalin nga përshkimi i vendit të punës. Ndërsa me datë 13.08.2025 ankuesi përmes kërkesës me numër protokolli 2514/2025 i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve që ti lejohet vazhdimi i punës me angazhim të reduktuar për shkak gjendjes shëndetësore. Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve me datë 15.08.2025 ka marr vendimin me numër 2514-1/2025 përmes të cilit ka refuzuar kërkesën e ankuesit lidhur me lejimin e orarit të shkurtuar të punës.

Kundër vendimit me numër protokolli 2514-1/2025 të datës 15.08.2025 ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kërkuar na Këshilli që ta anuloj vendimin e datës 12.08.2025 të Sekretarit të Përgjohem në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve, si dhe ti lejohet e drejta e vazhdimi të punës me orar të shkurtuar respektivisht 20 ore në javë.

Kolegji i Këshillit gjate analizimit te shkresave te lendes ka gjetur raportin mjekësor te datës 08.09.2025 te lëshuar nga Qendra Laserike e Syrit Kubati në të cilën rekomandohet që të punohet me orar të reduktuar dhe ambient me dritë të mjaftueshme, andaj ndërlidhur me pretendimin e ankuesit Kolegji i'u referua nenit 20 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik i cili përcakton se : *1. Zyrtarja/i publik ka të drejtë për kushte të përshtatshme për kryerjen e detyrave të punës, duke përfshirë mjedisin e sigurt dhe të shëndetshëm të punës në përputhje me legjislacionin përkatës për siguri në punë, si dhe ruajtjen e integritetit dhe dinjitetit të zyrtares/it publik. 2. Institucioni publik siguron mbrojtjen e të punësuarës/it gjatë ushtrimit të detyrës apo lidhur me të, përfshirë mbështetjen nga organet e specializuara, kur është e nevojshme. Si dhe nenit 7 paragrafi 1,2,3 dhe 5 te Rregullores (QRK) Nr.04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtareve Publik i cili përcakton se: 1. Orari i shkurtuar i punës caktohet për punët dhe detyrat e punës, për të cilat edhe përkundër aplikimit të masave mbrojtëse, zyrtari publik nuk mund të mbrohet nga ndikimet e dëmshme për shëndetin e tij. 2. Orari i punës shkurtohet në përpjesëtim me rrezikshmërinë për shëndetin dhe aftësinë punuese të zyrtarit publik. 3. Orari i shkurtuar i punës mund të reduktohet më së shumti deri në njëzet (20) orë në javë, për punët me shkallë të lartë të rrezikshmërisë, 5. Zyrtari publik i cili punon me orar të shkurtuar të punës, sipas paragrafit 1 të këtij neni, i gëzon të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës sikurse zyrtari publik me orar të plotë pune.*

Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, referuar dispozitave të cekura si më lartë, konstaton se nëpunësit civil kanë të drejtë që të punojnë me orar të reduktuar në raste kur është e nevojshëm për shëndetin e nëpunësve, si duke bashkangjitur raportet mjekësore me rekomandim se personi në fjalë duhet të punoj me orar të reduktuar, ndërsa është në diskrecion të Zyrtarit më të lartë administrativ të institucionit që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me kërkesën gjithnjë duke u bazuar në dokumentet apo raporte mjekësore të specialisteve të fushës përkatëse respektivisht dokumente bindëse përmes të cilave do të vërtetohet saktë dhe drejtë gjendja shëndetësore e ankuesit.

Andaj, duke qenë se eksitojnë prova të reja respektivisht raporte mjekësore lidhur me kërkesën për lejimin punës me angazhim të reduktuar respektivisht për këtë çështje administrative, Kolegji i Këshillit vlerëson që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve me detyrimin që i njëjti të rishqyrtoj kërkesën e ankuesit dhe nëse është e nevojshme të kërkoj dokumente apo raporte mjekësore tjera shtesë në mënyrë që të vërtetohet saktë dhe drejtë gjendja shëndetësore e ankuesit, si dhe të nxjerrë vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në mbështetje të fakteve të vërtetuara në mënyrë të plotë dhe drejtë.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1688/2025

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit V.L;
- Njesiese së Burimeve Njerezore në Ministrinë e Financav Punës dhe Tranfeereve
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave Punës dhe Tranfereve si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.